

**STATUT**  
**I SHOQËRISË AKSIONARE**  
**“LOAL PETROLEUM” Sh.A.**

*Në këtë statut:*

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.
- “Statuti” është statuti i shoqërisë, i cili do të interpretohet se përfshin dhe/ose inkorporon aktin e themelimit të shoqërisë, organizimin dhe funksionimin e të cilës rregullon.

**Kreu I**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

**Neni 1**

**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

- 1.1. Sot, më 28.05.2018 (njëzetë e tetë maj dymijë e tetëmbëdhjetë), themeluesi krijon një shoqëri aksionare me emrin “**LOAL PETROLEUM**” ShA. (me ofertë private).
- 1.2. Themelues i shoqërisë është:
  - Z. Fatmir Shabani, shtetas shqiptar, lindur më 02.07.1971 në Shikaj Kukës, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal H10702077G, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.

**Neni 2**

**Objekti**

- 2.1. Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm: *Tregtimi me shumicë i karburanteve të ndryshme, naftës dhe nënprodukteve të saj si dhe vajrave lubrifikante, te gazit te lengshem per ngrohje dhe pajisjeve te lidhura me to etj. Blerja, importimi, shitja e naftes dhe vajrave minerale te paperpunuar, transportimi per vete dhe per llogari te te treteve, depozitimi, perzierja, trajtimi, shitja, shperndarja me shumice e karburanteve dhe lendeve djegese ne pergithesi, qymyrit, gazit, lubrifikanteve, produkteve te naftes dhe naftokimike, duke perfshire ketu edhe bitumet. Blerja, shitja, qeradhenia, ndertimi dhe administrimi i impianteve, depozitave dhe administrimi i ndertesave dhe pasurive te veta te paluajteshme. Shoqëria mund të kryejë veprimtari të tjera të lidhura apo në funksion të objektit të mësipërm.*

**Neni 3:**

**Kohëzgjatja**

- 3.1. Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë e pacaktuar / e pakufizuar.



*Neni 4  
Selia*

- 4.1. Selia e Shoqërisë ndodhet ne adresën: *Shqipëri, Tiranë, Rruga LORD BAJRONI Hyrja - I.*

*Kreu II  
Kapitali*

*Neni 5  
Kapitali themeltar*

- 5.1. Kapitali i regjistruar i shoqërisë është *3.500.000 (tre milionë e pesëqind mijë) Lekë*, i ndarë në *3500 (tremijë e pesëqind) aksione të zakonshme* me vlerë nominale *1.000 (njëmijë) Lekë secili*.
- 5.2. Aksionet e themeluesve në kapitalin e shoqërisë janë në përputhje me kontributin e tyre të mëposhtëm:

Aksionari themelues	<i>Fatmir Shabani</i>
- Lloji i kontributit:	<i>Para</i>
- Numri i aksioneve:	<i>3500</i>
- Vlera e aksioneve:	<i>3.500.000 Lekë</i>
- Vlera e kontributit:	<i>3.500.000 Lekë</i>
Numri i përgjithshëm i aksioneve:	<i>3500</i>
Kapitali i regjistruar:	<i>3.500.000 Lekë</i>
Vlera e paguar:	<i>875.000 Lekë</i>

*Neni 6  
Kërkesa për të paguar aksionet*

- 6.1. Administratorët mund t'u kërkojnë aksionarëve pagimin e kontributeve të pashlyera në lidhje me aksionet e tyre. Njoftimi për pagesë mund të parashikojë shlyerjen me këste të kontributeve të papaguara. Personi të cilit i drejtohet njoftimi për pagesën e kontributit do të jetë përgjegjës për njoftimet që i drejtohen atij pavarësisht kalimit të mëpasshëm të pronësisë së aksioneve me të cilat lidhet njoftimi për pagesë.
- 6.2. Zotëruesit e përbashkët të një aksioni do të jenë përgjegjës bashkërisht dhe në mënyrë solidare për shlyerjen e kontributeve, sipas njoftimit të mësipërm.

*Neni 7  
Llojet dhe kategoritë e aksioneve*

- 7.1. Aksionet mund të jenë të zakonshme ose aksione me përparësi. Aksionet e zakonshme u japin zotëruesve të tyre tagër për të ushtruar në asamblenë e përgjithshme të drejtat e aksionarit dhe për të përfituar pjesë të fitimeve dhe të shpërndarjes së pasurive të mbetura pas likuidimit, në raport me pjesën e kapitalit që aksionet e tyre përfaqësojnë. Aksionet me



përparësi u japin zotëruesve të tyre tagrin që nga ndarja e dividendëve të vendosur nga asambleja e përgjithshme të përfitojnë një shumë të caktuar ose një përqindje të caktuar të vlerës nominale të aksioneve të tyre, përpara shpërndarjes së fitimeve, në favor të aksionarëve të zakonshëm, përparësi në ndarjen e pasurive të shoqërisë, të mbetura pas likuidimit dhe të drejta të tjera të përcaktuara me ligj apo në statut.

- 7.2. Aksionet, që japin të njëjtat të drejta, përbëjnë aksione të së njëjtës kategori (aksione të zakonshme, aksione me përparësi, aksione me të drejtë vote dhe aksione pa të drejtë vote).

### *Neni 8* *Regjistri i aksioneve*

- 8.1. Shoqëria aksionare mban një regjistër të posaçëm, ku regjistrohen të dhënat e zotëruesve të aksioneve të shoqërisë, si: emri e mbiemri i aksionarit, apo emri i regjistruar, nëse është person juridik, vlera nominale e aksionit, adresa e banimit apo zyra qendrore e aksionarit dhe data e kryerjes së regjistrimit.
- 8.2. Administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e regjistrit të aksioneve të shoqërisë e detyrohen të lejojnë aksesin në informacionet e regjistrit ndaj çdo aksionari apo çdo personi tjetër që e kërkon. Informacioni i regjistrit të aksioneve duhet të publikohet në faqen e shoqërisë në internet. Shoqëria mund të lejojë regjistrimin on-line të të dhënave, që duhen regjistruar sipas pikës 1 të këtij neni.
- 8.3. Administratori i Shoqërisë ngarkohet me detyrën e mbajtjes së regjistrit të aksioneve.

### *Neni 9* *Menyrat e fitimit dhe kalimit të Aksioneve*

- 9.1. Aksionet e shoqërisë aksionare dhe të drejtat, që rrjedhin prej tyre, mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet: kontributit në kapitalin e shoqërisë, në çastin e formimit të shoqërisë; shitblerjes; trashëgimisë; dhurimit; çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- 9.2. Aksionet e të drejtat e fituara si më sipër nuk mund të ushtrohen ndaj asnjë personi apo ndaj shoqërisë, përpara se veprimi të jetë regjistruar në regjistrin e posaçëm të aksioneve, që mban shoqëria, në përputhje me pikën 1 të nenit 119 të Ligjit 9901.

### *Neni 10* *Zmadhimi i Kapitalit Themeltar*

- 10.1. Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zmadhohet duke emetuar aksione rishtazi, kundrejt kontributeve të reja. Kur emetohen aksione të reja, këto aksione iu ofrohen aksionarëve ekzistues përpara se t'u ofrohen aksionarëve të tjerë të rinj, në pajtim me nenin 174 të Ligjit. Aksionet e reja iu ofrohen aksionarëve sipas numrit të aksioneve që zotërojnë përpara ofertës. Oferta që iu bëhet aksionarëve ekzistues duhet të pranohet brenda 20 ditësh pas publikimit në QKB.
- 10.2. Asambleja e përgjithshme mund të vendosë që zmadhimi i kapitalit të kryhet me emetim të aksioneve të reja, për t'u nënshkruar vetëm nga aksionarët ekzistues.



- 10.3. Zmadhimi i kufizuar i kapitalit mund të kryhet vetëm me miratimin unanimit të të gjithë aksionarëve.
- 10.4. Zmadhimi i kapitalit me aktivet e shoqërisë. Pas miratimit të bilancit të vitit paraardhës, asambleja e përgjithshme mund të vendosë ta zmadhojë kapitalin e regjistruar, duke kaluar në kapitalin bazë rezervat e disponueshme dhe fitimet e pashpërndara.

#### *Neni 11*

#### *Zvogëlimi i kapitalit themeltar*

- 11.1. Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të asamblesë së përgjithshme, në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 145 të ligjit 9901.
- 11.2. Nëse zvogëlimi ndryshon të drejtat e një kategorie të caktuar aksionesh, vlefshmëria e tij kushtëzohet nga pëlqimi i aksionarëve përkatës, i cili duhet të përmbushë kërkesat formale të pikës 3 të nenit 149 të këtij ligji.
- 11.3. Zvogëlimi i kapitalit realizohet nëpërmjet zvogëlimit të vlerës nominale të aksioneve dhe anulim aksionesh.
- 11.4. Kapitali i regjistruar mund të zvogëlohet nën vlerat minimale, të parashikuara në ligj, vetëm në rastin kur zvogëlimi shoqërohet me një zmadhim të njëkohshëm të kapitalit.

#### *Kreu III*

#### *Organet e shoqërisë*

#### *Neni 12*

#### *Organet e shoqërisë*

- 12.1. Organet e shoqërisë aksionare janë:
- Asambleja e përgjithshme;
  - Këshilli i Administrimit
  - Administratori/administratorët

#### *Neni 13*

#### *Asambleja e Përgjithshme*

- 13.1. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:
- a) përcaktimin e politikave tregtare;
  - b) ndryshime të statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e anëtarëve të këshillit të administrimit
  - d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - e) miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" e "d" të kësaj pike;
  - f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - g) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
  - h) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;



- i) pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
  - j) ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
  - k) përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;
  - l) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - m) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
  - n) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti.
- 13.2. Asambleja e përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e këshillit të administrimit dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.
- 13.3. Nëse shoqëria zotërohet nga një aksionar, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga aksionari i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga aksionari i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet e mëposhtme:
- a) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - b) shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i humbjeve;
  - c) zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
  - ç) vendimet për investime;
  - d) riorganizimi dhe prishja e shoqërisë.
- Vendimet e paregjistruara në regjistrimin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

#### *Neni 14*

##### *Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme*

- 14.1. Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratorët dhe nga anëtarët e Këshillit të Administrimit, apo nga aksionarët e përcaktuar sipas nenit 139 të Ligjit 9901.
- 14.2. Rastet e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme i parashikon Neni 136 i Ligjit.
- 14.3. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim, nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik dhe rendi i ditës u dërgohen të gjithë aksionarëve, jo më vonë se 21 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

#### *Neni 15*

##### *Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme*

- 15.1. Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme vetëm me arritjen e kuorumit të parashikuar nga neni 144 i Ligjit.
- 15.2. Gjatë mbledhjes së asamblesë së përgjithshme përgatitet lista e aksionarëve të pranishëm dhe të përfaqësuesve të tyre, ku shënohen emrat dhe adresat e secilit, së bashku me numrin e aksioneve, numrin e votave, që këto aksione japin, vlerën nominale të aksioneve, si dhe



- llojin apo kategorinë e tyre, të zotëruara nga secili pjesëmarrës. Kjo listë u vihet në dispozicion aksionarëve dhe përfaqësuesve të tyre dhe nënshkruhet prej tyre.
- 15.3. Asambleja e përgjithshme cakton një kryetar.
  - 15.4. Nëse asnjë prej Administratorëve nuk dëshiron të caktohet si Kryetar i mbledhjes ose nëse asnjë prej Administratorëve nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes, aksionarët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre si Kryetari të mbledhjes.
  - 15.5. Administratori ose anëtar i Këshillit të Administrimit pavarësisht se nuk është aksionar, ka të drejtën e pjesëmarrjes si edhe të marrë fjalën në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme dhe në mbledhjet e veçanta të aksionarëve, zotërues të aksioneve të klasave të ndryshme.

#### *Neni 16* *Kuorumi*

- 16.1. Në rastin e çështjeve, që vendosen me shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm ose të përfaqësuar aksionarët, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të aksioneve, me të drejtë vote. Kur asambleja duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 145 të Ligjit 9901, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse aksionarët, që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote, apo përfaqësuesit e tyre, marrin pjesë në votim personalisht ose votojnë me shkresë apo me mjete elektronike, sipas parashikimeve të nenit 142 të këtij ligji.
- 16.2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### *Neni 17* *Marrja e vendimeve*

- 17.1. Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të aksionarëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 17.2. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera të parashikuara në nenin 14 të këtij statuti.

#### *Neni 18* *Këshilli Administrimit*

- 18.1. Asambleja e Përgjithshme cakton tre ose më shumë, por jo më shumë se 21, persona fizikë si anëtarë të Këshillit të Administrimit, në pajtim me shkronjën "c", pika 2 të nenit 135 dhe pikën 2 të nenit 155 të Ligjit. Emërimet do të jenë individuale dhe në përputhje me vendimin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë votash, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si anëtar të Këshillit të





- Administrimit. Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të shkarkohen nga detyra në çdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme, pa cenuar të drejtat që burojnë nga një kontratë pune e lidhur me Shoqërinë.
- 18.2. Shumica e anëtarëve të Këshillit të Administrimit do të jenë të pavarur dhe nuk do të jenë Administratorë, në përputhje me parashikimet e pikës 1 dhe 4 të nenit 155 të Ligjit.
- 18.3. Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të caktojnë një person i cili dëshiron të veprojë në cilësinë e anëtarit të Këshillit të Administrimit, duke pasur parasysh se emërimi nuk përbën zmadhim të numrit të anëtarëve, të përmendur në pikën 1 të këtij neni. Anëtari i Këshillit të Administrimit i emëruar në këtë mënyrë do të jetë në detyrë deri në mbledhjen vjetore vijuese të Asamblesë së Përgjithshme.
- 18.4. Personat e mëposhtëm emërohen si anëtarë të parë të Këshillit të Administrimit të Shoqërisë me një mandat që do të zgjasë deri në zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Administrimit nga Mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme sipas nenit 135/2/c të Ligjit, por në çdo rast mandati i tyre nuk do të zgjasë për më shumë se 3 (tre) vjet:
- **Z. Arsen Prifti**, shtetas shqiptar, mbajtës i numrit personal G70621030T.
  - **Z. Ndriçim Dervishi**, shtetas shqiptar, mbajtës i numrit personal G90628092W.
  - **Z. Tahir Mamaçi**, shtetas shqiptar, mbajtës i numrit personal G70528009K.

#### *Neni 19*

#### *Kompetencat e Këshillit të Administrimit dhe Komiteteve të tij*

- 19.1. Këshilli i Administrimit udhëzon Administratorët në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe kontrollon përputhshmërinë e tyre me ligjin dhe Statutin. Detyrat e mbikëqyrjes së Këshillit të Administrimit, sipas shkronjave “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, “e”, “ë”, “f”, “g”, dhe “i” të pikës 1 dhe pikës 2 të nenit 154 të Ligjit, nuk mund t’iu delegohen Administratorëve.
- 19.2. Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund ti delegojnë kompetencat e tyre çdo komiteti i cili përbëhet nga një ose më shumë anëtarë të këtij këshilli. Delegimi i këtyre kompetencave mund të kryhet në përputhje me kushtet e vendosura nga anëtarët e Këshillit të Administrimit dhe këto kompetenca mund të revokohen ose të ndryshohen. Anëtarët e Këshillit të Administrimit nuk mund të delegojnë detyrat që u janë ngarkuar me ligj.
- 19.3. Për sa më lart, Këshilli i Administrimit do të krijojë:
1. një komitet, i cili përcakton standardet për emërimin e Administratorëve;
  2. një komitet, i cili përcakton skemën e shpërblimit dhe shpërblimin individual të Administratorëve dhe anëtarëve të Këshillit të Administrimit;
  3. një komitet për kontrollin e mbarëvajtjes dhe kontabilitetit të Shoqërisë.
- 19.4. Komitetet përbëhen nga një ose më shumë anëtarë të Këshillit të Administrimit, shumica e të cilëve duhet të jenë të pavarur dhe të mos merren me administrimin e Shoqërisë.
- 19.5. Komitetet e emërimit, shpërblimit dhe kontrollit japin rekomandime të cilat synojnë përgatitjen e vendimeve që duhen marrë nga Këshilli i Administrimit. Qëllimi kryesor i komiteteve është rritja e efikasitetit të Këshillit të Administrimit duke u kujdesur që vendimet të merren në mënyrën e duhur si edhe të ndihmojnë organizimin e punës me synim sigurimin e vendimmarrjes që nuk përbën konflikt të interesave materiale. Krijimi i



- komiteteve nuk zhvendos çështjet e marra në shqyrtim nga Këshilli i Administrimit i cili mbetet organi përgjegjës për vendimet e marra në fushën e tij të kompetencës.
- 19.6. Në veçanti, komiteti i kontrollit financiar:
1. mbikëqyr procesin e raportimit financiar;
  2. mbikëqyr efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe sistemit të administrimit të rreziqeve;
  3. mbikëqyr kontrollin e bilanceve vjetore dhe të konsoliduara, sipas Statutit;
  4. shqyrton dhe mbikëqyr pavarësinë e ekspertëve kontabël të autorizuar ose të shoqërisë së ekspertëve kontabël të autorizuar dhe, në veçanti, ofrimin e shërbimeve të tjera shtesë për subjektin e kontrolluar.
- 19.7. Ndryshimet e statutit dhe udhëzimeve të Asamblesë së Përgjithshme nuk do të shfuqizojnë akte të mëparshme të Këshillit të Administrimit, të cilat do të ishin të vlefshme nëse ndryshimi nuk do të ishte kryer ose udhëzimi nuk do të ishte dhënë.

#### *Neni 20*

#### *Mbledhjet e Këshillit të Administrimit*

- 20.1. Mbledhjet e Këshillit të Administrimit do të mbahen të paktën dy herë në vit sipas nevojave të aktivitetit tregtar të Shoqërisë, derisa Asambleja e Përgjithshme të vendosë me shumicë të zakonshme votash mbi shpeshhtësinë e mbledhjeve të Këshillit të Administrimit.
- 20.2. Vendimet e Këshillit të Administrimit merren me kuorumin e përcaktuar në nenin 162 të Ligjit. Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të marrin pjesë në mbledhje nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit përfshirë komunikimin video dhe audio konferencë. Ata mund të marrin pjesë në votime duke përdorur numrin PIN të lëshuar çdo anëtar i në momentin e emërimit.
- 20.3. Anëtarët e Këshillit të Administrimit emërojnë njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes, i cili mund të shkarkohet në çdo kohë nga kjo detyrë. Administratori nuk mund të emërohet si Kryetar i Këshillit të Administrimit. Kryetari do të drejtojë çdo takim të Këshillit të Administrimit në të cilin ai është i pranishëm. Në rast se Kryetari nuk dëshiron të drejtojë mbledhjen apo nuk është i pranishëm brenda pesë minutave nga orari i caktuar për mbledhjen, anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të emërojnë njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.
- 20.4. Çështjet e rendit të ditës vendosen me shumicën e votave të pjesëmarrësve. Në rast numri të barabartë votash, vota e Kryetarit do të jetë vendimtare.
- 20.5. Të gjitha aktet e kryera nga mbledhja e anëtarëve të Këshillit të Administrimit, ose komitetet e anëtarëve të Këshillit të Administrimit, ose nga persona të cilët veprojnë si anëtarë të Këshillit të Administrimit, pavarësisht nëse bëhet e ditur më pas se emërimi i anëtarit të Këshillit të Administrimit ka pasur mangësi ose këta anëtarë janë skualifikuar nga mbajtja e kësaj detyre, ose nuk kishin të drejtë të votonin, do të konsiderohen të vlefshme njëllë sikur këta persona të ishin emëruar rregullisht dhe të ishin cilësuar e të vazhdonin detyrën si anëtarë të Këshillit të Administrimit dhe të kishin të drejtë të votonin në mbledhje.
- 20.6. Vendimi me shkrim i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Këshillit të Administrimit që kanë të drejtë të njoftohen për mbledhjen e Këshillit të Administrimit ose të komitetit të





anëtarëve të Këshillit të Administrimit do të konsiderohet si i vlefshëm dhe i efektshëm njëloj si të ishte miratuar në mbledhjen e Këshillit të Administrimit ose në komitetin e anëtarëve të Këshillit të Administrimit, të thirrur dhe mbledhur rregullisht.

#### *Neni 21*

##### *Procesverbali i Mbledhjes së anëtarëve të Këshillit të Administrimit*

- 21.1. Anëtarët e Këshillit të Administrimit do të mundësojnë mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve në libra të posaçëm për:
1. të gjithë emërimet e kryera nga anëtarët e Këshillit të Administrimit; dhe
  2. të gjithë mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, mbledhjet e zotëruesve së aksioneve të klasave të ndryshme, dhe mbledhjet e Këshillit të Administrimit dhe komiteteve të Këshillit të Administrimit, përfshirë edhe emrat e anëtarëve të Këshillit të Administrimit të pranishëm në këto mbledhje.

#### *Neni 22*

##### *Shkarkimi i anëtarëve të Këshillit të Administrimit*

- 22.1. Detyra e anëtarit të Këshillit të Administrimit përfundon në rast se:
1. personi nuk është më anëtar i Këshillit të Administrimit në bazë të dispozitave të Ligjit përfshirë nenin 157 dhe pikën 7 të nenit 158.
  2. personi ndodhet në gjendje paaftësie paguese;
  3. personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
  4. personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë, ose
  5. ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e anëtarëve të tjerë të Këshillit të Administrimit në mbledhjet e këtij këshilli të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe Këshilli i Administrimit vendos ta shkarkojë nga detyra.

#### *Neni 23*

##### *Administratorët*

- 23.1. Këshilli i Administrimit zgjedh një ose më shumë persona fizikë si Administratorë dhe përfaqësues të Shoqërisë për një periudhë trevjeçare, në pajtim me nenin 158 të Ligjit. Emërimet do të jenë individuale dhe sipas një vendimi të Këshillit të Administrimit, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si Administrator. Administratorët mund të shkarkohen në çdo kohë nga detyra, pa çënuar të drejtat që burojnë nga një kontratë pune e lidhur me shoqërinë.
- 23.2. Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të caktohen si Administratorë për sa kohë që shumica e anëtarëve të Këshillit të Administrimit përbëhet nga persona të pavarur që nuk ushtrojnë kompetenca administrimi.
- 23.3. Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të Shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Këshillit të Administrimit të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme, në përputhje me nenin 135/2/c të Ligjit, por në çdo rast mandati i tyre nuk do të zgjasë për më shumë se 3 (tre) vjet:



- **Z. Fatmir Shabani, shtetas shqiptar, lindur më 02.07.1971 në Shikaj Kukës, mbajtës i leternjoftimit me nr. personal H10702077G.**
- 23.4. Politikat tregtare të Shoqërisë do të administrohen dhe Shoqëria do të përfaqësohet nga Administratorët të cilët mund të ushtrojnë të gjitha kompetencat e tyre në përputhje me parashikimet e pikës 3 dhe 5 të nenit 158 dhe nenin 159 të Ligjit. Detyrat e Këshillit të Administrimit, në përputhje me parashikimet e shkronjave “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, “e”, “ë”, “f”, “g” dhe “i” të pikës 1 të nenit 154 nuk mund t’iu delegohen Administratorëve.
- 23.5. Ndryshimet e statutit nga Asambleja e Përgjithshme dhe të udhëzimeve të Këshillit të Administrimit nuk do të shfuqizojnë akte të mëparshme të Administratorëve, të cilat do të ishin të vlefshme nëse ndryshimi nuk do të ishte kryer ose udhëzimi nuk do të ishte dhënë.

#### *Neni 24*

##### *Shkarkimi i Administratorëve*

- 24.1. Detyra e Administratorit përfundon në rast se:
1. personi nuk është më Administrator në bazë të dispozitave të Ligjit përfshirë shkarkimin nga Asambleja e Përgjithshme në pajtim me pikën 2 të nenit 167, dhe shkronjën “c” të pikës 2 të nenit 135 të Ligjit;
  2. personi ndodhet në gjendje paaftësie paguese;
  3. personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
  4. personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë, ose
  5. ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e Këshillit të Administrimit në mbledhjet e Administratorëve të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe Asambleja e Përgjithshme, me propozim të Këshillit Mbikëqyrës, vendos ta shkarkojë nga detyra.

#### *Kreu IV*

##### *Ekspertët, Dividendët dhe Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar*

#### *Neni 25*

##### *Ekspertët Kontabël të Autorizuar*

- 25.1. Me propozim të Këshillit të Administrimit, Asambleja e Përgjithshme me vendim të zakonshem emëron një ose më shumë persona fizikë ose një shoqëri auditimi si ekspertë kontabël të autorizuar të pavarur të shoqërisë për një periudhe nga 1 (një) deri në 3 (tre) vjet me radhë, sipas përmbajtjes së vendimit. Ekspertët mund të shkarkohen mbi bazën e një vendimi të marre me shumicë të zakonshme nga Asambleja e Përgjithshme.
- 25.2. Ekspertët e parë kontabël të shoqërisë të emëruar për një mandat 1 (një) vjeçar caktohen:
- **Znj. Lefteri Kushta**, shtetase shqiptare, e lindur më 15.10.1958 në Gjirokastrë, mbajtëse e leternjoftimit me numër personal F86015149Ë, mbajtëse e licencës nr.58.
  - **Znj. Gerta Avrami**, shtetase shqiptare, lindur më 24.01.1977 në Tiranë, mbajtëse e leternjoftimit me numër personal H75124110Ë, mbajtëse e licencës nr. 348.



*Neni 26*  
*Dividendët*

- 26.1. Në përputhje me dispozitat e Ligjit, shoqëria me shumicë të zakonshme të votave së Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë dividendët në përputhje me të drejtat përkatëse të aksionarëve.
- 26.2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me aksionet, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumat e paguara për aksionet për të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët pjesëtohen dhe paguhen në përpjesëtim të drejtë me shumat e paguara për aksionet, pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhet dividendi; në rast se aksioni emetohet me kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë e caktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.
- 26.3. Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një aksion nuk prodhon interesa kundrejt shoqërisë nëse një gjë e tillë nuk parashikohet në të drejtat e aksionit.
- 26.4. Çdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e maturimit, në rast se vendoset nga Asambleja e Përgjithshme, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që ta paguajë atë.

*Neni 27*  
*Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar*

- 27.1. Administratorët, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të kualifikuar votash sipas kuorumit të përcaktuar nga neni 145 i Ligjit, mund të vendosë të kalojë në kapitalin themeltar të Shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezerva ligjore ose kapitali.

*Kreu V*  
*Prishja dhe njoftimet*

*Neni 28*  
*Prishja dhe likuidimi*

- 28.1. Në rast të likuidimit të Shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e posaçëm të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë të kualifikuar, mund të shpërndajë në dobi të aksionarëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të Shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis aksionarëve ose atyre që zotërojnë aksione të klasave të ndryshme të Shoqërisë.



*Neni 29*  
*Baza Ligjore*

- 29.1. Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 29.2. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e Ligjit 9901/2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar, Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter të posaçëm ne Republikën e Shqiperise.

*Neni 30*  
*Mosmarrëveshjet*

- 30.1. Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Per te kryer te gjithë veprimet per regjistrimin e shoqerise ne regjistrin tregtar, per te nenshkruar dhe depozituar formen e aplikimit dhe cdo dokument tjeter te nevojshem sipas ligjit, autorizohet Z.Fatmir Shabani, shtetas shqiptare, mbajtës i numrit personal H10702077G.

*Aksionari Themelues i Shoqërisë "LOAL PETROLEUM" Sh.A.*  
*Perfaqesuar nga*  
*Fatmir Shabani*

FATMIR SHABANI  
